

NJOFTIM PER SHTYP

Në datën 18 shtator 2014, z. Ditmir Bushati, Ministër i Punëve të Jashtme, priti në një takim z. Goran Svilanovic, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC) me qëndër në Sarajevë.

Takimi u zhvillua në kuadër të Kryesinë shqiptare të Procesit të Bashkëpunimit të vendeve të Europës Jug-Lindore (SEECP) dhe në të u diskutua dhe u shkëmbyen pikpamje për të koordinuar aktivitetet dhe kapacitetet ndërmjet Presidencës së sonë të SEECP-s dhe Sekretariatit të RCC.

Në kuadër të prioritetëve të kryesisë së SEECP-s bashkëbiseduesit nënvizuan zhvillimet e rëndësishme për proceset integruese në BE të vendeve të Ballkanit Perëndimor, që inicioi Konferenca e Berlinit, 28 gusht 2014.

“Ndjekja dhe realizimi në proces i katër fushave të bashkëpunimit të shprehura në këtë Konferencë: 1- infrastruktura, 2- energjia, 3- SME-të dhe zhvillimi i kapitalit njerëzor, 4- turizmi, do të jenë në qëndër të prioritetëve dhe të aktivitetëve të kryesisë sonë, nënvizoi z. Bushati në takim.

Ministri Bushati e informoi bashkëbiseduesin mbi vullnetin e qartë të palës sonë për të qënë pjesëmarrëse aktiv në proceset bashkëpunuese rajonale. Gjatë takimit u diskutua dhe u ra dakort për një koordinim më të frytshëm të punës, me synim realizimin me sukses të kryesisë shqiptare të SEECP-s për periudhën 2014-2015, si dhe rritjen e rolit të vendit tonë në këtë strukturë të rëndësishme rajonale.